# DËSHMI ARKIVI

**A-468621**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Italia ashpërson rregullat në shkolla: Ndalohet burka dhe nikabi |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1394076.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 11:35:25 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 25 shtator 2026, 11:31:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 25 shtator 2026, 11:30:00 UTC → 25 shtator 2026, 11:32:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `3fbcf1c33396c701a9fbea022b8fe552dfd80724976c5b1532b82120fb320886` |
| TEKSTI | `c58e2bbdc2782ac3fb737fd8944cba27462c05d776ee112a1d1787261a75adc4` |
| PAMJA | `dbd9e97f4001f0c5e25799b2d434c74b674386bdf5148c2f62ce061e4575e864` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `261c762bc7921a004c3b2417d7d4f5a1f3dba9673ecc19494c9989116036b1b3` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `3f529bf32420afe1b21bc6d3b8138bcb5df45885bcaf02ba5967dcac0a879fe4` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/261c762bc7921a004c3b2417d7d4f5a1f3dba9673ecc19494c9989116036b1b3`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Italia ashpërson rregullat në shkolla: Ndalohet burka dhe nikabi

Shkruar nga: A Shehaj | Publikuar më: 25.09.2026, 13:31

Share Share




Qeveria italiane ka miratuar një dekret që ndalon përdorimin e burkës dhe nikabit në shkolla, ndërsa vendos një kufi prej 30% për nxënësit me njohuri të pamjaftueshme të gjuhës italianenë një klasë.

Kryeministrja Giorgia Meloni i cilësoi masat si "mjete të arsyeshme që nuk ndajnë, por ndihmojnë integrimin", duke thënë se synimi është shmangia e krijimit të "klasave geto" dhe garantimi i mundësive të barabarta për nxënësit.

Ndalimi vlen për burkën dhe nikabin, ndërsa hixhabi mbetet i lejuar, pasi nuk mbulon fytyrën. Meloni ka deklaruar se nxënësit duhet të shkojnë në shkollë me fytyrën e zbuluar, duke e lidhur masën me sigurinë, integrimin dhe të drejtat e grave dhe vajzave.

Kufiri 30% do të zbatohet në nivele të ndryshme arsimore për nxënësit pa shtetësi italiane, në varësi të kohës që kanë kaluar në sistemin shkollor italian. Në rastet kur kufiri nuk mund të respektohet, parashikohen përjashtime dhe mësim shtesë i italishtes.

Dekreti ka hyrë menjëherë në fuqi, por duhet të miratohet nga Parlamenti brenda 60 ditësh.

Opozita e ka kundërshtuar masën, duke akuzuar qeverinë se po e përdor çështjen e emigracionit për qëllime politike përpara zgjedhjeve të ardhshme. Organizata Save the Children ka paralajmëruar gjithashtu për rrezikun e efekteve diskriminuese ndaj fëmijëve.

Ministri i Arsimit, Giuseppe Valditara, ka mbrojtur vendimin, duke theksuar se kriteri për nxënësit është kryesisht gjuhësor dhe jo i bazuar vetëm te shtetësia.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR



Më të Lexuarat

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.